

1 E martë, 8 tetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Konferencë përgatitore për gjykim]

4 [Të akuzuarit Januzi dhe Bahtijari paraqiten
5 përmes videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 15.00

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Mirëdita dhe mirë se erdhët në ditën e dytë dhe të fundit të
9 Konferencës për Përgatitjen për Gjykim.

10 Znj. Sekretare e seancës, ju lutem, paraqisni lëndën.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar

12 Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2023-10, Prokurori i

13 Specializuar kundër Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi
14 Shalës.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 Do i kërkoja palëve dhe pjesëmarrësve që të prezantohen.

17 Do të fillojmë me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

18 Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit. Mirëdita, të nderuar

19 Gjykatës, unë jam Joshua Hafetz dhe së bashku me mua janë

20 kolegët e mi Jonathan Ellis [Sipas përkthimit] dhe Line

21 Pedersen që është menaxhere e çështjeve.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit. Tani kalojmë te Zyra Administrative.

24 Zëvendësadministrator, e keni ju fjalën.

25 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit. Ne jemi njësoj siç

1 ishim dhe dje. Është i pranishëm, jam unë Jonas Nilsson,
2 Zëvendësadministrator dhe së bashku me mua është Whitney Price
3 që është eksperte ligjore.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
5 rregull.

6 Ju lutem do i kërkoja palëve që të prezantoheshit
7 ndërkohë që një pjesë të ekipeve e kemi të pranishme në sallën
8 e gjyqit, ndërkohë që një pjesë po na ndjekin përmes
9 videolidhjes.

10 Do të vazhdoj me Mbrojtjen për z. Shala.

11 Z. CADMAN: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Jam
12 Toby Cadman, jam Mbrojtja e Specializuar për z. Shala. Z.
13 Shala ka hequr dorë nga e drejta e tij për të marrë pjesë në
14 këtë seancë për arsye që besoj që ju, të nderuar Gjykatës, i
15 dini. Së bashku me mua është edhe John Cubborn, që është
16 bashkëmbrojtësi; dhe Isabella Kirwan, që është eksperte
17 ligjore; dhe hetuesi Admir Berisha.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
19 mirë.

20 Z. CADMAN: [Përkthim] I gjithë ekipi jonë është këtu i
21 pranishëm në sallën e gjyqit dhe nuk kemi askënd që e ndjek
22 procesin në distancë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
24 rregull. Jemi të informuar dhe për arsyet se pse klienti juaj
25 nuk është i pranishëm këtu.

1 Tani kalojmë tek Mbrojtja e z. Bahtijari.

2 ZNJ. CARRIN: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës, z.
3 Bahtijari na ndjek përmes videolidhjes nga Njësia e
4 Paraburgimit. Gjithashtu, përmes videolidhjes na ndjek dhe
5 Caitlin Delaney dhe Phillipa Stafford, që është eksperte
6 administrative. Ndërkohë në sallë kemi gjithashtu edhe Daphe
7 Jung Liun [Sipas përkthimit].

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
9 rregull.

10 Z. Rees, fjala për juve që është Mbrojtësi i z. Januzi.

11 Z. REES: [Përmes përkthimit] [Përkthim] Ne ju ndjekim me
12 videolidhje. Unë Jam Jonathan Rees, jam Mbrojtësi i
13 Specializuar, ndërkohë që klienti im ju ndjek përmes
14 videolidhjes.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
16 mirë.

17 Sikurse e thamë edhe dje ne sot do të japim një grup
18 urdhrash gojorë. Këto urdhra marrin parasysh datën e
19 parashikuar nga Trupi Gjygues për fillimin e gjykimit,
20 përkatësisht datën 8 nëntor 2024.

21 Përpara sesa vijojmë meurdhat gojorë, Trupi Gjygues
22 dëshiroj të trajtojë dy çështje paraprake të cilat dua që të
23 trajtohen në seancë private.

24 Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

25 [Seancë private]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
13 jemi në seancë publike.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Tani kalojmë tek urdhrat gojorë. Kemi disa urdhra gojorë.

17 Urdhri i parë gojor ka të bëjë me një kërkesë nga
18 Mbrojtja e z. Januzi që është parashtruar në parashtrimin e
19 protokolluar F511. Është urdhër gojor që ka të bëjë për
20 shtyrjen e fillimit të gjykimit që lidhet konkretisht me
21 paragrafin 4 të dosjes F00511.

22 Trupi Gjygues vëren Mbrojtja e Januzit e fton Trupin
23 Gjygues që të shtyjë fillimin e gjykimit pas seancës për
24 hapjen e çështjes me 8 nëntor 2024, deri me datë 13 nëntor
25 2024 për të vijuar më tej me thirrjen e dëshmitarit të parë të

1 Prokurorisë si rezultat i angazhimeve të mëparshme të avokatit
2 me datën 11 dhe me datën 12 nëntor 2024, sikurse i është
3 transmetuar dhe i është bërë me dije Trupit Gjykses me 4 tetor
4 2024, domethënë përpara një jave. Trupi Gjykses më tej vëren
5 se Mbrojtja e Januzit nuk shpjegon se pse bashkëmbrojtësi nuk
6 mund të përfaqësojë z. Januzi për dëshmitarin apo dëshmitarët
7 e parë të Prokurorisë. Për pasojë Trupi Gjykses vendos se, në
8 rast nevoje, z. Januzi do të përfaqësohet nga bashkëmbrojtësi,
9 i cili më parë ka thënë që është i disponueshëm me datë 11 dhe
10 12 nëntor 2024 në të njëjtin parashtrim me numër F00504.

11 Së fundi, Trupi Gjykses mban parasysh konfirmimin e
12 Mbrojtjes së z. Shala, z. Bahtijari sa i takon gatishmërisë së
13 tyre dhe disponueshmërinë për të filluar gjykimin me datën 8
14 nëntor 2024, dhe me seanca me dëshmitarë në javën nga 11 deri
15 në 15 nëntor 2024, siç është transmetuar në dosjet përkatëse
16 të dy ekipeve me numrat përkatës 509 dhe 510.

17 Ky është fundi i vendimit të parë gojor të Trupit
18 Gjykses.

19 Urdhri tjetër gojor ka të bëjë me mënyrën e
20 modalitet që lidhet me zhvillimin e procedurave dhe praktikën
21 për përgatitjen e dëshmitarëve.

22 Trupi Gjykses mban parasysh parashtrimet e ZPS-së si dhe
23 propozimet lidhur me aspektet e mëposhtme që kanë të bëjnë me
24 zhvillimin e procedurave: së pari, dorëzimin dhe
25 provueshmërinë e dëshmimeve jogojore, paragrafët 29 deri në 32

1 dhe 36 dhe 37 të parashtimit F491; së dyti, karakterin publik
2 të procesit, paragrafët 38 deri në 39 të parashtimit të
3 protokolluar 491; dhe së treti, karakterin e drejtë dhe të
4 shpejtë të procesit gjyqësor që reflektohet në paragrafët 40,
5 41 të të njëjtit parashtim.

6 Trupi Gjykses i fton ekipet e Mbrojtjes që të dorëzojnë
7 parashtime me shkrim në qoftë se e konsiderojnë të arsyeshme
8 lidhur me propozimet e lartpërmendura e bëra nga Zyra e
9 Prokurorit të Specializuar jo më vonë sesa të mërkurën, 16
10 tetor në orën 4.00. Trupi Gjykses më tej fton ekipet e
11 Mbrojtjes që të dorëzojnë parashtime në qoftë se dëshirojnë
12 lidhur me praktikën e përgatitjes së dëshmitarëve, jo më vonë
13 sesa të mërkurën, 16 tetor 2024, në orën 4.00, duke marrë
14 parasysh parashtimet e ZPS-së sikurse ato janë dhënë me
15 hollësi në paragrafët 16 deri në 23 të parashtimit të
16 protokolluar 491 si edhe praktikën e mëparshme të Trupit
17 Gjykses në çështje të mëparshme.

18 Ky është fundi i fundi i urdhrin gojor të Trupit Gjykses
19 numër 2.

20 Ndërkohë, urdhri tjetër gojor ka të bëjë me kërkesat e
21 Mbrojtjes -- me kërkesën e Mbrojtjes së Januzit që ZPS-ja të
22 bëjë të disponueshme për Mbrojtje kopjet forenzike të
23 telefonave mobil të dëshmitarëve, një, sikurse përcaktohet në
24 paragrafët 5 dhe 18 të parashtimeve të veta në parashtimin
25 me numër F495.

1 Trupi Gjykses mban parasysh parashtrimet e mëparshme të
2 palëve mbi këtë aspekt të parashtruara gjatë Konferencës për
3 Përgatitjen e Çështjes të hënën, me datë 7 tetor 2024. Trupi
4 Gjykses vëren veçanërisht parashtrimet e ZPS-së që ZPS-ja nuk
5 ka në zotërimin e vet kopjet forenzike të telefonave mobil të
6 dëshmitarit 1 dhe dëshmitari 04891. Trupi Gjykses gjithashtu
7 vëren se palët janë pajtuar që të përfshihen në konsultime
8 *inter partes* mbi këtë aspekt dhe për rrjedhojë kërkojnë
9 autorizimin përkatës të Trupit Gjykses. Shihni për këtë
10 transkriptin e datës 7 tetor 2024, konfidencial, në faqen 286,
11 rreshti 19 dhe faqen 292, rreshti 5.

12 Trupi Gjykses gjithashtu ka marrë parasysh kuadrin e
13 autorizimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për krijimin
14 e kopjeve forenzike të telefonave mobil të Dëshmitarit 1 dhe
15 Dëshmitari 4891, në veçanti i referohemi paragrafit të
16 vendimit të parashtrimit F141 dhe paragrafit 35 të vendimit
17 F151.

18 Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykses i urdhëron
19 palët që të përfshihen në biseda *inter partes* dhe në qoftë se
20 vendosin të dorëzojnë një kërkesë të përbashkët me shkrim duke
21 kërkuar autorizimin përkatës Trupit Gjykses jo më vonë sesa të
22 enjten, më datë 10 tetor në orën 4.00. Këto kërkesa duhet të
23 kenë formën e një kërkesa për ndihmë në pajtim me nenin 55(1)
24 paragraf i Ligjit dhe duhet që të japim hollësi si dhe
25 justifikime përkatëse sa i takon kuadrin të materiale ose

1 informacionit që kërkohet.

2 Përveç kësaj Trupi Gjykses e urdhëron ZPS-në që të
3 kontaktojë sa më shpejt që të jetë e mundur me institutin
4 forenzik të jashtëm për të ditur se kur kopje të tilla
5 forenzik të telefonave mobil të dëshmitarëve përkatës mund të
6 vihen në dispozicion, mund të jenë të disponueshme për palët
7 dhe të informojnë Trupin Gjykses për informacion e marrë dhe
8 kjo duhet të bëhet jo më vonë sesa të enjten me datë 10 tetor,
9 në orën 4.00.

10 Ky është fundi i urdhrin të tretë gojor të Trupit
11 Gjykses.

12 Tani do të vazhdojmë me urdhrin e katërt që ka të bëjë me
13 provueshmërinë e provave të dorëzuara nga ZPS-ja.

14 Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në që të dorëzojë çdo kërkesë
15 për pranimin e provave jогоjore përfshirë dhe dy materialet që
16 janë objekt i kundërshtimeve të mundshme prej Mbrojtjes, jo më
17 vonë se deri të martë, n me 15 tetor 2024. Për hir të
18 shpejtësisë së procesit Trupi Gjykses gjithashtu vendos në
19 bazë të rregullës 9(5)(a) të Rregullores që t'i shkurtojë
20 afatet për përgjigjet dhe kundërpërgjigjet si vijon: Mbrojtja
21 duhet të dorëzojë përgjigjet ndaj kërkesave të ZPS-së jo më
22 vonë se të martën, me 22 tetor 2024, domethënë mbas një jave;
23 dhe ZPS-ja të dorëzojë çfarëdo kundërpërgjigje ndaj
24 përgjigjeve të Mbrojtjes jo më vonë se të premtën me 25 tetor
25 2024.

1 Këtu përfundon ky urdhër gojor i Trupit Gjykues.

2 Urdhri me radhë gojor ka të bëjë me dorëzimin e listave
3 të dëshmitarëve prej ekipeve të Mbrojtjes në përputhje me
4 rregullën 119(1) të Rregullores. Trupi Gjykues ka marrë
5 parasysh parashtrimet e mëtejshme të ekipeve të Mbrojtjes të
6 bëra në konferencën përgatitore të mbajtur në hënën, me 7
7 tetor 2024, si dhe ato në parashtrimin me shkrim të Mbrojtjes
8 të Januzit me numër 511.

9 Trupi Gjykues vëren se Mbrojtja e Bahtijarit dhe ajo e
10 Shalës kanë bërë të ditur se listat e tyre të dëshmitarëve
11 mund të dorëzohen deri të hënën, me 4 nëntor, kurse Mbrojtja e
12 Januzit ka bërë të ditur se do të mund ta bëjë këtë, pra të
13 dorëzojë listën e dëshmitarëve deri të hënën, me 18 nëntor
14 2024. Trupi Gjykues gjithashtu mban parasysh se sipas
15 Mbrojtjes së Januzit në parashtrimin 511, vlerësimet e
16 përafërta në lidhje me kohën që do t'i duhet Mbrojtjes për të
17 paraqitur provat në emër të z. Januzi, mund të jepen deri me 4
18 nëntor 2024.

19 Duke marrë këto parasysh dhe duke mbajtur parasysh
20 gjithashtu edhe datën e parashikuar për fillimin e gjykimit
21 Trupi Gjykues i udhëzon ekipet e Mbrojtjes që t'i dorëzojnë
22 listat e tyre të dëshmitarëve jo më vonë se të hënën, me 4
23 nëntor 2024. Në përputhjen me rregullën 119(1) të Rregullores.
24 Çdo parashtrim duhet të përfshijë kohën e parashikuar për
25 prezantimin e provave të Mbrojtjes; dy, numrin e përgjithshëm

1 të dëshmitarëve që pritet të dëshmojnë për çdo të akuzuar veç
2 e veç duke përfshirë edhe vetë të akuzuarit në qoftë se do të
3 dëshmojnë; emrat dhe pseudonimet e çdo dëshmitari; një
4 përmbledhje të fakteve për të cilat do të dëshmojnë ata
5 dëshmitarë dhe në rast se Mbrojtja nuk ka qasje tek një
6 dëshmitar, atëherë duhet të jep shpjegim se çfarë pret prej
7 atij dëshmitari dhe në lidhje me çfarë do të dëshmojë ai;
8 pretendimet në aktakuzë apo akuzat e paraqitura në aktakuzë
9 për të cilat priten të dëshmojnë ata dëshmitarë duke iu
10 referuar çdo pike të akuzës dhe paragrafëve në aktakuzë;
11 pastaj në qoftë se dëshmitarët do të dëshmojnë drejtpërdrejtë
12 në sallë të gjyqit apo nëpërmjet mënyrave të tjera të parapara
13 në Rregullore; dhe kohëzgjatjen e pritshme për pyetjen e
14 dëshmitarëve.

15 Përveç kësaj, ekipet e Mbrojtjes udhëzohen që të
16 përfshijnë në parashtrimet e tyre dhe kërkesa për masa
17 mbrojtëse që mund të jenë të nevojshme për dëshmitarët si edhe
18 çfarëdo kërkesë për lëshimin e fletëthirrjeve sipas rregullës
19 121(3) të Rregullores.

20 Gjithashtu, për hir të shpejtësisë së procesit Trupi
21 Gjykues në bazë të rregullës 9(5) (a) të Rregullores, vendos që
22 të shkurtojë afatet për dorëzimin e përgjigjeve dhe
23 kundërpërgjigjeve si vijon: ZPS-ja duhet të përgjigjet në çdo
24 kërkesë të Mbrojtjes jo më vonë se të hënën, me 11 nëntor
25 2024; kurse Mbrojtja duhet të dorëzojë kundërpërgjigje ndaj

1 përgjigjeve të mundshme të ZPS-së, jo më vonë se të enjten, me
2 14 nëntor 2024.

3 Këtu përfundon ky urdhër gojor.

4 Urdhri tjetër gojor ka të bëjë me leximin e përmbledhjes
5 së aktakuzës në hapjen e procesit gjyqësor.

6 Trupi Gjykses ka marrë parasysh marrëveshjen që -- të
7 Mbrojtjes të Shalës dhe të z. Bahtijari që ZPS-ja ta lexojë
8 një përmbledhje të aktakuzës në hapjen e paraqitjes së provave
9 të ZPS-së në vend të të gjithë tekstit të aktakuzës. Dhe Trupi
10 Gjykses ka marrë gjithashtu parasysh edhe parashtrimet e
11 Mbrojtjes së Januzit të paraqitura në Konferencën Përgatitore
12 më 7 tetor, që do të bëhen diskutime *inter partes* në lidhje me
13 këtë çështje.

14 Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në dhe Mbrojtjen e Januzit që
15 të parashtrojnë një propozim të përbashkët në lidhje me
16 përmbledhjen e aktakuzës ose ta informojnë Trupin Gjykses për
17 një propozim të tillë për të cilën kanë rënë dakord jo më vonë
18 se me 1 nëntor, të premtën.

19 Trupi Gjykses thekson se ZPS-ja dhe Mbrojtja e Januzit
20 duhet të arrijnë *agreement* një marrëveshje dhe që aktakuza të
21 lexohet në hapjen e çështjes simbas rregullës 124(2) të
22 Rregullores.

23 Këtu përfundon ky urdhër gojor.

24 Urdhri tjetër gojor është ky.

25 Në lidhje me afatet për paraqitjen e kërkesave të ZPS-së

1 për ndryshimin e listës së provave materiale.

2 Trupi Gjykses urdhëron ekipet e Mbrojtëseve që t'i
3 përgjigjen kërkesave të ZPS-së jo më vonë se të premtën, me 11
4 tetor; dhe ZPS-në, që në qoftë se dëshiron, të bëjë
5 kundërpërgjigje jo më vonë se të martën, me 2024.

6 Gjithashtu, Trupi Gjykses ka marrë parasysh se sipas ZPS-
7 së ajo do të paraqesë një kërkesë më vete në lidhje me
8 materialin që nuk e ka në posedim aktualisht, dhe se këtë
9 material do t'ia nxjerrë Mbrojtjes kur ta merr atë. I
10 referohet transkriptit të 7 tetorit konfidencial, faqe 341
11 rreshtat 18 deri 25 dhe parashtrimin 512, paragrafi 7.

12 Trupi Gjykses vëren se në këtë drejtim sipas ZPS-së këto
13 materiale nuk janë shumë të gjata dhe nuk përmbajnë shumë
14 informacion të ri. Dhe këtu i referohem parashtrimeve të ZPS-
15 së të bëra në seancën e të hënës, në transkriptin me faqe 297,
16 rreshtat 25, deri në faqe 312 rreshti 13, dhe duke marrë këto
17 parasysh Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në të dorëzojë kërkesën
18 dhe/ose të nxjerrë materialin e pa nxjerrë deri më tani të
19 identifikuar në paragrafët 3 dhe 4 të parashtrimeve të veta sa
20 më shpejt që është e mundur.

21 Gjithashtu, Trupi Gjykses mban parasysh parashtrimet e
22 bëra nga zoti avokat i z. Januzi, të paraqitura në Konferencën
23 e mbajtur të hënën me 7 tetor, që nuk është në gjendje të bëjë
24 hetimet e ekspertit sikurse edhe theksohet në paragrafin 4 të
25 parashtrimeve të Mbrojtjes Januzi në parashtrimin 495, deri sa

1 ZPS-ja t'i nxjerrë çdo material -- të nxjerrë çdo material të
2 pa nxjerrë që ka të bëjë me telefonat e sekuestruar.

3 Trupi Gjykses gjithashtu ka mbajt parasysh edhe problemet
4 që ngriti Mbrojtja e Januzit në lidhje me parashikimet për
5 kontraktimin e hetuesve të jashtëm, apo konsulentë, sipas
6 Rregullores për Ndhmën Juridike.

7 Dhe në bazë të udhëzimeve për administrimin dhe
8 monitorimin e zbatimit të Rregullores së Ndhmës Juridike për
9 të bërë organizimet e nevojshme, si për shembull, sigurimin e
10 ndihmës së ekspertit për të vazhduar për procedurën pa pagesa
11 dhe vonesa të panevojshme. Në këtë drejtim, Trupi Gjykses hedh
12 poshtë parashtrimet e Mbrojtjes së Januzit që do të mund të
13 kryejë këtë hetim prej eksperti pas nxjerrjes së materialit të
14 pa nxjerrë. Përkundrazi, në qoftë se pas nxjerrjes së këtyre
15 materialeve të panxjerra kryhet punë shtesë nga eksperti i
16 duhur, Mbrojtja e Januzit mund t'i kërkojë Zyrës
17 Administrative, Zyrës së Mbrojtjes edhe fonde apo financim të
18 mëtejshëm për mbulimin e këtyre shpenzimeve.

19 Dhe së fundi Trupi Gjykses ka mbajt parasysh që ekipet e
20 Mbrojtjes së z. Januzi dhe z. Shala kanë parashtruar gjatë
21 Konferencës Përgatitore se kanë vështirësi në qasjen për të
22 siguru qasje në dosjet në kopjet forenzike të telefonave,
23 gjashtë telefonave të konfirmuar. Dhe tani i referohem
24 transkriptit të djeshëm të faqes 313, rreshtat 6 deri në faqe
25 316 rreshtat 17.

1 Në këtë drejtim Trupi Gjykses konstaton se është e
2 përshtatshme që të udhëzojë ZPS-në dhe Zyrën Administrative që
3 t'i japin ndihmën teknike të nevojshme ekipeve të Mbrojtjes
4 duke përfshirë edhe ekipin e z. Bahtijari sipas nevojës për
5 t'u siguruar qasje në materialet e lartpërmendura deri të
6 mërkurën, me 9 tetor 2024.

7 Këtu përfundon ky urdhër i Trupit Gjykses.

8 Tani do të kalojmë te urdhri i radhës, gojor. Ky urdhër
9 ka të bëjë me udhëzimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake
10 në lidhje me klasifikimin në paragrafin 58(d) dhe (g) të
11 urdhrit me numër 469.

12 Trupi Gjykses ka mbajtur parasysht se që nga kalimi i
13 çështjes Trupit Gjykses me 4 shtator 2024, palët kanë dorëzuar
14 rregullisht versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të
15 tyre përkatëse sipas udhëzimeve të Gjykatësit të Procedurës
16 Paraprake të dhëna në atë urdhër. Trupi Gjykses udhëzon palët
17 që çdo parashtrim të mbetur që nuk është dorëzuar në formë të
18 redaktuar publike të dorëzohet deri të hënën, me 21 tetor
19 2024.

20 Dhe tani do të shkojmë tek lista e urdhrave që ka
21 ndërmend të lëshojë Trupi Gjykses deri në fillimin e gjykimit.
22 Dhe këto janë vendimi për caktimin e datës për fillimin e
23 gjykimit. Meqë Trupi Gjykses aktualisht ka ndërmend që të
24 fillojë gjykimin të premtën, me 8 nëntor 2024, ai do të
25 nxjerrë një vendim në lidhje me këtë dhe Trupi Gjykses i

1 falënderon të gjithë palët që kanë siguru disponueshmërinë dhe
2 gatishmërinë e tyre për këtë.

3 Pastaj do të nxirret dhe një vendim në lidhje me
4 përgatitjen e dëshmitarëve dhe njoftimin e tyre me procedurat
5 në Gjykatë.

6 Do nxirret edhe vendim për zhvillimin e gjykimit dhe ky
7 vendim do të përfshijë dhe afatet për ekipet e Mbrojtjes për
8 të dorëzimin e parashtrimeve të tyre në lidhje me provat
9 materiale të propozuara prej tyre në bazë rregullës 110(2)(b)
10 të Rregullores.

11 Dhe një vendim në lidhje me parashtrimin e provave
12 jोगojore dhe provueshmërinë e tyre.

13 Këtu në qoftë se nuk keni diçka për të shtuar i drejtohem
14 një herë Prokurorisë.

15 Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo, nuk kemi asnjë gjë për të
16 shtuar.

17 Z. NILSSON: [Përkthim] Nuk kemi asnjë gjë për të shtuar.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Mbrojtja e z. Shala.

20 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk kemi asnjë gjë për të shtuar.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Mbrojtja e z. Bahtijari.

23 ZNJ. CARRIN: [Përkthim] Nuk kemi asnjë gjë për të shtuar.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Mbrojtja për z. Januzi.

1 Z. REES: [Përmes përkthimit] [Përkthim] Nuk kemi asnjë
2 gjë për të shtuar.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtu
4 përfundon seanca publike. I falënderoj palët dhe Zyrën
5 Administrative për praninë e tyre. Falënderoj përkthyesit,
6 ekipin audio-vizual dhe të sigurisë për ndihmën e tyre.

7 Këtu përfundon seanca.

8 --- Seanca mbyllet në orën 15.35

9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25